

PASURIA GJUHËSORE NË "KANUNIN E LEKË DUGAGJINIT" (Varianti i Pukës)

Në *Kanunin e Lekë Dukagjinit* (varianti i Pukës) pasuria gjuhësore e shqipes është shpalosur në tërë gjerësinë dhe thellësinë e saj. Nuk besoj të ketë vepër tjetër ku gjuha shqipe të paraqitet aq saktë, aq e përkryer e në të njëjtën kohë e ndërtuar krejt thjesht, por gjithsesi e aftë për të shprehur në mënyrë të plotë norma morale e juridike që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet njerëzve. Mbase është edhe merita e z. Meçi, që një pjesë të përmbledhjes e ka dhënë me shkronja kursive, duke ruajtur të paprekur formulimin e vetë vendësve.

Kanuni është ligj dhe ligji nuk duhet të ketë ekuivoke. Populli i krahinës së Pukës, që është autori i këtij *Kanuni*, i ka shprehur këto norma kaq qartë sa nuk mund t'u heqësh e as t'u shtosh asnjë fjalë pa prishur kuptimin e tyre. Gjithçka është në vendin e vet e me funksion të caktuar përsosmërisht me objektin që trajton. Këndej shumë shprehje të këtij *Kanuni* kthehen në sentenca jo vetëm tejet të sakta, po shpesh edhe të argumentuara e disa herë të dhëna edhe me ngjyrimë artistike. *Fjala* në *Kanunin e Pukës* është "gur i çmuar", ajo nuk hidhet "pa kontroll", përndryshe po gabove detyrohesh të *paguash gjobën*. Prandaj duhet të jesh i matur. *Fjala*, pra kthehet në gur miliar që tregon se nga duhet ecur, po edhe si duhet ecur. Në këtë mes ajo kthehet në një mjet të fuqishëm ekzekutiv. Forca e fjalës në këtë *Kanun* është mahnitëse. S'ka asgjë mangut e asgjë tepër. Ka një kursim të tejshkajshëm të saj në një ndërtim konciz të përkryer e për t'u pasur zili. Idiomat këtu kthehen në aksioma, të cilat pranohen pa diskutim. Khs. këtu *Grueja e huej nuk preket me dorë, E di shpijaku kur përpushet zjarmi, Berrejšmi i humb të gjitha, Në shpi të huej nuk hyhet pa të zonë, Marren e lan pushka* etj.

Të përkryera paraqiten normat e arsyetuara. Së pari jepet në mënyrë tepër koncize veprimi a fakti; më pas edhe argumentimi

Gjuhësi

i domosdoshmërisë së kryerjes së tij. Khs. *E bani, s'e bani pula vonë; s'ruej pulën tande!, Në va s'i dilet kuj në pritë. Gjaksorët të lypin vend tjetër, O laj, o lsho çiken e huej. Kush me zort s'të ka ba me e xanë, E pëlqeve para se me e xanë; ça do me i pa tash?!, Dazem pa mish nuk ka; banu gati pra, E pëlqeve, bleje; s'e pëlqeve, lee. Gja me zort s'po të nep kush!*

Disa sentenca shprehen me një mendim të prerë. Ata janë tepër të qarta, prandaj kërkojnë zbatim pa mëdyshje. E kush nuk i zbaton, *E bje, në mend katundi!*. Khs. *Me zort nuk mbahen bashkë gjindtë e shpisë!, Qeni do hekrat e hekrat janë në dorë të zot, Pse je shpi e madhe, mos i hap krahët përtej pashit tand, Varret nuk i preken as i trazohen kuj. As hasmit. I paburri ka punë me varret e hueja!, Mortimort, miku-mik! Ndryshe koritesh, Gjithkush ka vendin e vet. Lypja e gjeja etj.*

Shpirti i pukjanit njeh edhe të bukurën në shprehjen e normave që rregullojnë etikën morale të tij. Shprehjet: *Korinë e çikës nuk mund e durojnë malet!, Njerka s'bahet nanë: Nana-diell e njerka-hanë!, Nderi i grues asht si gatarja. U thye, s'gjitet ma!* etj. janë për t'u marrë si shembull ndërtimi artistik.

Fjalitë eliptike me ndërtime tejet lakonike, do të mbeten gjithnjë si kryevepra të vërteta të sintaksës popullore, ende e studiuar fare pak. Si shembull po marr katër fjalë, të cilat sqarojnë pa asnjë mëdyshje të gjitha diskutimet që ka bërë parlamenti ynë në ligjin për pronësinë e tokës. Thuhet tepër qartë në *Kanu* se si duhet zgjidhur kjo pronësi: *I zoti tokën - puna bimën*. Në këto dy fjali lapidare, mungon kallëzuesi. Sepse, në këto raste kallëzuesi del i tepërt. Ka një mësim universal në *Kanu*, që duhet mbajtur gjithnjë parasysh: *Mos hec me kambët e tua e me mendt e hueja, dhe Kush shkon në gjyq me kambët e veta e me mend të tjetërkuj - paguen gjobën!*

Ndërtimet sintaksore në *Kanu* janë pjesa më pak e studiuar e që ia vlen gjithnjë të bëhen objekt diskutimi. Shembujt: *Ma plaku - te oxhaku, Kufini kufinin e ha, Kufi mbi kufi kanuja nuk ban etj.*, janë perla gjuhësore ku mendimi dhe fjala përputhen përsosmërisht.

* * *

Përpjekja për të dhënë një mendim sa më të saktë, zakonisht

Gjuhësi

shoqërohet edhe me nevojën e krijimit të fjalëve të reja e të kup-timeve të reja, si edhe me formime të ndryshme para e prapash-tesore. Në këtë drejtim *Kanuja* është *minierë* e pafund.

Së pari, pasuria e madhe e kompozicionit (juxtapozicionit a pranëvënies) e deri te përngjitjet, çka tregon se pukjani e ka kërkuar fjalën dhe ia ka arritur ta ndërtojë në natyrën e së folmes së vet. Krahas kompozitave pak a shumë të njohura si *berrejshëm*, *bespremë*, *gjakhupës*, *kryekcyem*, *kryeshëndosh*, *kryeulët*, *krushkapar*, *mikpremë*, *ngucakeq*, *thekpremë* etj., ka krijuar edhe kompozita të tjera tepër të goditura si *shtiekeq*, *kryemveti*, *kryeherët*, *kanopkali*, *dypërnjah* etj. Tashmë dihet që kompozicioni shpreh gjithnjë vitalitetin e një gjuhe.

Neologjizmat në *Kanu* janë të shumta e mbi të gjitha të ndër-tuara bukur. Khs, këtu p.sh. *tregtore* për "dyqan", *veshatare* "ajo që vesh nusen", *gjamatarë* "ata që bëjnë gjamën", *pritarë* "ata që dalin në pritë", *ngucatarë* "ata që ngucin kënd", *bashkari*, *palutë* "ulur, palosur", folja *prapoj* "me u prapsur", që e ndeshim edhe te cikli i kreshnikëve, *njome-ja* në shprehjen "bukën e njomen" etj., të cilat krejt mirë mund të përdoren edhe sot, duke e pasu-ruar gjuhën e sotme letrare shqipe me atë leksik aq shprehës e të bukur të Veriut të vendit, që është lënë në harresë pa shkak.

Në *Kanu* dalin edhe shumë fjalë të rralla si *brac* "vjedhës", *çarim* në shprehjen *në korrje e në çarim*, folja /me/ *kue*, *mashtabë*, *hallakat*, /me/ *shafitë*, me gjasë metateza e foljes tjetër me të njëjtin kuptim "me fashitë", *kmendë* në dubletën *lesh e kmendë* etj., gjithashtu edhe formime me parashtesa e prapashtesa, khs. /me/ *përgojue*, /me/ *ndërkambë*, *gojaçe*, *bestar*, /me/ *hjek sue* etj.

Fjalë të huaja në *Kanu* ka pak; janë kryesisht sllave (*caran*, *çar-ranik*, *dever* "djali që shoqëron nusen duke tërhequr kalin për freri" etj.) e turke (*bedel*, *jerevi*, *osull*, *takam* etj.).

Mungesa e huazimeve në *Kanunin* e Pukës flet në të mirë të burimit vendës. Ndikimet e huaja ngjan të jenë të pakta e të pa-përfillshme. Ky është tregues i qartë i zanafillës autentike të tij.

Leksiku i *Kanunit* mund të bëhet objekt edhe për historinë e gjuhës shqipe. Ne po analizojmë këtu vetëm dy fjalë: *spanispar* dhe *meteh*. E para, në kontekstin *Nusja shkon në gjini spanispar dy javë mbas martese ...* mund të zbërthehet a analizohet "se panit të parë", pra "për herë të parë", ku *pan-* është folja /me/ *pa* në

Gjuhësi

trajtën arkaike të pjesores me *-n*, që nuk përdoret më në gegërishte, po që vazhdon të gjallojë në toskërishte në formën *parë*.

Fjala e dytë *meteh*, në kontekstin *kufini asht gur a meteh*, ka kuptimin "shenja për të përcaktuar kufirin e një are". Gazulli jep edhe variantin *metef-i*, fjalë e përdorur edhe në Malësi të Madhe e në Mirditë, me dy kuptime "1. - kufi dhe 2. - vend i naltuem e në të lam" (*Fjalorth*, f. 262). Pasi bën krahasimet me serbokroatishten dhe me greqishten, jep shpjegimin e plotë: "Në Kanu të Lekës guri i kufinit për me u pranue si i tillë do t'ishte i sjellun me teh kundruell gurit tjetër". Këndeje Gazulli na qet në rrugë për të gjykuar se *meteh* paraqet një përngjitje me kuptimin "me teh", ku *me* është parafjalë e *teh-u* "anë e mprehtë". Kemi të bëjmë këtu me një fjalë që shpjegohet nëpërmjet shqipes e me mjetet e saj e që mund të bëhet zanafilla e etimologjisë së emrit të kahnës që quhet *Metohi*.

Ravizuam thërrmia gjuhe vetëm duke prekur drejtimet kryesore nga duhet nisur studimi i *Kanunit të Lekë Dulagjinit* (varianti i Pukës) në pikëpamje gjuhësore.

E theksojmë edhe njëherë se ky variant është burim i vërtetë, një gurrë e pashtershme, ku gjuhëtari mund të shuajë gjithnjë etjen. E bash për këtë duhet përgëzuar z. Meçi, që me përkushtim ka ruajtur trajtat origjinale, duke u dhënë gjuhëtarëve *lëndën e parë* për punime e studime të mëtejshme.